



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu

Thirrje publike për aplikim për pjesëmarrje në shtandin shtetëror të Kosovës në panairin e turizmit “ITB BERLIN” në Berlin/Gjermani

Data e organizimit:

03-05 mars 2026

Adresa: Berlin, Gjermani

Me qëllim të promovimit të potencialeve turistike të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), fton operatorët turistik të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtar. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e stendës (pikë kontaktuese dhe qasje në hapësirat e hapura dhe të mbyllura për takime B2B për çdo takim që aranzhojnë me kohë), regjistrimin e deri 8 subjekteve pjesëmarrëse nga sektori i turizmit (operatorë turistikë), shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse.

Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 11.02.2026 Dokumentet e plotësuar si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar me të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës. Certifikata e biznesit me informata;
3. Dëshminë e xhirollogarisë aktive në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
4. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
5. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
6. Deklaratën nën betim;
7. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2025 nga

- Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); dhe
8. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK-së, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Shënim: Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme, aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet.

Kriteret e vlerësimit:

- Produktet turistike inbound që do të ju ofrohen turistëve në panair, maksimum 10 pikë:
 - 1 pikë për 1 produkt turistik inbound
 - 3 pikë për 2 produkte turistike inbound
 - 5 pikë për 3 produkte turistike inbound
 - 7 pikë për 4 produkte turistike inbound
 - 10 pikë për 5 e më shumë produkte turistike inbound
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Gjermane 5 pikë
 - Gjuhë Angleze 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
 - Gjuhë Gjermane 4 pikë
 - Gjuhë Angleze 4 pikë dhe
 - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Aktiviteti primar turistik i subjektit aplikues, maksimum 10 pikë:
 - Tour operatorë 10 pikë
- Pjesëmarrja në panaire periudha 2022-2025
 - Nje (1) panaire, dy (2) pikë
 - Dy(2) panaire katër (4) pikë
 - Tre (3) panaire gjashtë (6) pikë,
 - Katër (4) panaire tetë (8) pikë
 - Pesë (5) e më shumë panaire dhjetë(10) pikë

Më 29.01.2026 në ora 14:00, në sallën e takimeve të KIESA-s, organizohet sesioni informues ku zyrtarët e KIESA-s do të përgjigjen pyetjeve lidhur me organizimin e panairit dhe mbështetjen e kompanive për pjesëmarrje në këtë panair. Subjektet që kanë nevojë për asistencë për plotësimin e këtij formulari, këshillohen gjithashtu të marrin pjesë në këtë takim.

Të drejtën e aplikimit e kanë të gjitha kompanitë (operatorët turistike) vendore të cilat promovojnë potencialet turistike të Republikës së Kosovës

Përparësi në përzgjedhje do të kenë subjektet të cilat nuk kanë marr pjesë në panaire ndërkombëtare në dy vitet e fundit të organizuara nga MINT/KIESA.

Në rastet kur nuk plotësohet numri maksimal i subjekteve të kërkuara sipas kritereve për pjesëmarrje, atëherë do të merren parasysh aplikuesit tjerë të radhës.

Operatoret turistike që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 11.02.2026 në e-mail adresën: Export.Kiesa@rks-gov.net

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informatat dhe dokumentet e kërkuara për aplikim mund të merren në KIESA-MINT, apo të shkarkohen nga faqet e internetit:

mint.rks-gov.net dhe kiesa.rks-gov.net apo në e-mail adresën:
Export.Kiesa@rks-gov.net